



DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE

LISTA E OJQ-VE TË DISKUALIFIKUAR SIPAS THIRRJES PUBLIKE KORRIK-2023  
NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SOCIALE

Duke u bazuar në nenin 16, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, paragrafi 3 të Rregullores MF - NR – 04/2017, Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe në bazë të vendimit të caktuar sipas Vendimit 14-020/05-105136/23 të dt. 25.05.2023 të Kryetari i Komunës së Prishtinës, për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike të projekteve të organizatave jo-qeveritare në fushën e shërbimeve sociale; të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar; Fëmijët në situata të rënda sociale/pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik përhumbjen e kujdesit prindëror, viktima të dhunës në familje, trafikim me qenie njerëzore, keqtrajtimit, situatë rruge, bullizimit; të rriturit në situata të rënda sociale, viktima të dhunës në familje, trafikim me qenie njerëzore, keqtrajtimit, situatë rruge, ngacmimit, të moshuarit, minoritetet etnike, komuniteti LGBT, përdoruesit e substancave narkotike, amiljet përfituese të skemës së ndihmës sociale dhe me kushte të rënda socio-ekonomike.

Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** lista e OJQ-ve (organizatave jo qeveritare) aplikuese sipas thirrjes publike për mbështetje financiare publike të projekteve të organizatave jo-qeveritare: në fushën e shërbimeve sociale si vijon:

Nr.	Emri OJQ-së	Emri i Projektit	Totali i pikëve	Mos përmbushja e kriterëve të përgjithshme dhe kriterëve specifike të thirrjes publike
-----	-------------	------------------	-----------------	--

				<b>Mungesë dokumentacioni</b>
<b>1</b>	<b>Action for Development and Empowement of Communities - ADEC</b>	Strategjia e aftësimit dhe riaftësimit profesional për suksesin ne karriere	41.4	Organizata aplikuese përkundër se dëshmon kapacitete profesionale për realizmin e projektit, relevanca e projektit nuk është ne linjë me me termat e thirrjes publike per financim, për shkak se ngatërrohet ofrimi i shërbimeve sociale për grupet etnike me zhvillimin profesional te përfituesve në projekt. Organizata nuk ka asnjë lloj përvojë te punës ne te kaluarën në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Prandaj qëllimi madhor bie ne kundërshtim me objektivat specifik. Po ashtu organizatës i mungon certifikata nga gjykata me afat.
<b>2</b>	<b>Forumi Për Integrim Social</b>	Edukimi dhe vetëdijesim i fëmije rreth dukurive negative sikurse dhuna, bullizmi dhe sjelljet e rrezikshme.	40.6	Komision konstaton se nuk i përgjigjet termave të thirrjes publike për financim te OJQ-ve per ofrim te shërbimeve sociale dhe nuk definuar rezultatet e përgjithshme.
<b>3</b>	<b>ETEA</b>	Peer-to-peer(P2P) Mentoring Program	38.4	Aplikuese në momentin e identifikimit te problemit flet për sfidat e përfshirjes se komuniteteve në procesin edukativo -arsimor në Kosovë, por thirrja publike për mbështetje financiare është e fokusuar në trajtimin e nevojave dhe sfidave të përfituesve në Komunën e Prishtinës. Pastaj në shpjegimin e objektiveve organizata aplikuese nuk saktëson në mënyrë të qartë identifikimin e

				përfituesve në projekt si dhe i mungon përvoja në ofrimin e shërbimeve sociale.
4	<b>Pikë Kthese</b>	Mirëqenie në bashkëndjesi 2	37.6	Stafi i organizatës aplikuese nuk ka deklaruar në formularin e buxhetit se kanë marrëdhënie tjera pune (në CV-të e stafit të gjithë kanë punë primare tjera), gjithashtu projekti nuk ka specifikuar lidhshmërinë e objektivave dhe aktiviteteve. Gjithashtu organizata përveç një raporti nga ana e tyre nuk kanë faktuar me dëshmi përvojën në menaxhim të projekteve të ngjashme, si dhe mungojnë deklaratat e stafit që deklarojnë se janë pjesë e projektit. Dokumentacioni është i pakompletuar
5	<b>Organizata Social Psikologjike</b>	Integrim social i viktimave të krimit përmes mbështetjes psiko - sociale	35.6	Organizata aplikuese në shpjegimet e projektit nuk e arsyeton që projekti ka relevance për të përmbushur orientimet strategjike të drejtorisë së mirëqenies sociale dhe thirrjes publike dhe si i tillë nuk i përmbush kriteret për përkrahje financiare.
6	<b>Bussines menagment and Training Center- BMTC</b>	Fuqizimi i grave përmes stimulimit në punësim në komunën e Prishtinës	34	Komisioni ka konstatuar se kapacitetet profesionale të kësaj organizate nuk garantojnë realizim të suksesshëm të projektit. Objektivat, aktivitetet janë të paqarta dhe konfuze. Komisioni ka vlerësuar se nuk i merr piket e mjaftueshme për tu përzgjedhur fituese e thirrjes publike për financim.

7	<b>IZHI- Instituti për Zhvillim dhe integrim</b>	“Informimi dhe edukimi i fëmijëve në parandalimin e bullizmit kibernetikë”	33.2	Objektivat janë të paqarta. Aplikuesi nuk dëshmon në shpjegimin e projektit se ka kompetencë në zbatimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngacmimin (bullizmin) ndërmjet fëmijëve. Po ashtu Organizata në bazë të dokumenteve është e licencuar për ofrim të shërbimeve të punësimit dhe jo për ofrimin e shërbimeve sociale dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet.
8	<b>Future Developemt Center</b>	Fuqizimi i fëmijëve në ngritje e vetëdijes për të drejtat e tyre	33.0	Projekti nuk i përmbush termat e thirrjes publike për financim të OJQ-ve po ashtu e gjithë përshkrimi i projektit është i paqartë i cili dëshmon se rezultatet janë të paqarta dhe të paqëndrueshme dhe nuk i kontribuon objektivave strategjike të drejtorisë së mirëqenies sociale.
9	<b>EcoKosWomen</b>	Vitet janë numra III	31.4	Komisioni konstaton që organizata aplikuese nuk dëshmon se mund të vazhdojë me zbatimin e aktiviteteve nga e kaluara. Përgatitja e strukturës menaxhuese të projektit e nuk e bind komisionin se ka të gjithë kompetencat shkatheshit për të realizuar dhe ofruar shërbime të tilla specifike në përputhje me nevojat e kategorisë e cila është përzgjedhur për tu intervenuar dhe përkrahur. Komisioni konstaton ky projekt nuk merr pikët e mjaftueshme për tu mbështetur nga thirrja publike financiare.

10	<b>Advancing Together</b>	Promovimi i Ndërgjegjësimi Historik mes rinise se Kosovës: Përkujtimi i gjenocidit ndaj Romeve	30.2	Organizata aplikuese është një organizate e cila në bazë të dëshmive, dëshmon se ka përvojë në realizmin e projekteve por që për zgjedhjen e përfituesve është në kundërshtim me thirrjen publike që përfituesit të jenë të identifikuar dhe të për zgjedhur nga Komuna e Prishtinës, pasi që Buxheti i Komunës së Prishtinës është i dedikuar për qytetarët e saj në përputhje me ligjet e aplikueshme për financat publike. Po ashtu OJQ-së i mungojnë dëshmia e Gjykatës që s'është nën administrim të dhunshëm dhe CV-të e stafit.
11	<b>Handicap Kosova</b>	Ofrimi i shërbimeve Psiko- sociale, logopedike dhe edukative për persona me aftësi të kufizuara	28.6	Organizata aplikuese në shpjegimet për stafin profesional të cilët do të jenë përgjegjës për realizmin e aktiveteve të projektit nuk dokumentohet se i përkasin fushës specifike për të cilën organizata ka pohuar se do të ofrojë shërbime, një shërbim i tillë i specializuar kërkon ekspertizë specifike profesionale kualifikim adekuat, përvojë të gjatë dhe licencë në fushën logopedisë, psikologjike dhe mjekësore të cilat nuk dëshmohen që janë, përveç kësaj një dimension i projektit i takon domenit të shëndetësisë për të cilën thirrja publike është e fokusuar në ofrimin e shërbimeve sociale andaj një projekt i tillë nuk i plotëson kriteret të marr poenët

				për te arritur ne fushën e kualifikimit.
12	<b>ISDD- Instituti për Zhvillim te Qëndrueshëm Demokratik</b>	“REACT- për te Drejtat e Fëmijëve”	28.2	Komisioni ka konstatuar se Organizata nuk e ka projektin në përputhje me termat e thirrjes publike për financim. Përcaktimi i objektivave të projektit nuk është në përputhje me orientime strategjike të drejtorisë, po ashtu përzgjedhja e përfituesve është e paqartë.
13	<b>Islamic Relief Kosova</b>	Mësim plotësues për fëmijët jetim & rastet sociale	26.6	Organizata aplikuese i mungojnë dokumentet sipas kriterëve dhe kërkesave të thirrjes publike dëshmia nga dhunshëm ose falimentim nga gjykata. Gjithashtu vërtetimi tatimor nga ATK është i vjetër ( jo valid). Komisioni konstaton se projekti nuk kualifikohet për mbështetje financiare
14	<b>ICAC- Innovation in civic activism</b>	Trajnimi dhe përgatitja e personave nga grupet e marginalizuara dhe fëmijët e rrugës për tregun e punës	24	Komisioni ka konstatuar se Organizata nuk posedon kapacitetin të udhëheq projektin në fjalë, nuk i ka të qarta objektivat e projektit dhe nuk dëshmon përvojë sipas kriterëve të shpalljes në zbatimin e projekteve të tilla.
15	<b>Lëvizja Kasaba</b>	E ardhmja ime, profesioni im	23.9	Organizata aplikuese nuk ka definuar përfituesit çartë si përfitues në projekt duke mos saktësuar lokacionin vetëm ne Komunën e Prishtinës. Komfor aktiviteve të listuar ne projektet, komisioni konstaton se projekti nuk përmbushë kushtet për mbështetje financiare.
16	<b>HAVE HOPE</b>	Me te fortë se frika	18	Komisioni Have Hope nuk i përmbush kërkesat dhe

				objektivat e thirrjes publike, për financim. OJQ-ja aplikuese nuk ka kapacitet në realizimin e projektit sepse dëshmitë e stafit nuk janë bindëse dhe nuk tregojnë aftësi të menaxhimit të projektit, po ashtu ky projekt nuk i kontribuon politikave të mirëqenies sociale të komunës së Prishtinës.
17	<b>Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7</b>	Promovimi i të drejtave socio-ekonomike të grave dhe përmirësimi i mirëqenies përmes aftësisë profesionale dhe punësimit.	16.8	Komisioni ka konstatuar se Organizata në fjalë ka mungesë të dokumentacionit në bazë të kriterëve të thirrjes publike për financim si dhe nuk dëshmon që ka përvojë të ngjashme në zbatimin e projekteve të tilla
18	<b>Shtëpia ime, e drejta ime</b>	Promovimi i të drejtave të rinjve të të komunitetit RAE dhe fuqizimi i rolit të tyre në sfidimin e dhunës në familje.	16.4	Komisioni ka konstatuar se Organizata në fjalë ka mungesë të dokumentacionit sipas kriterëve të thirrjes publike për financim. Andaj edhe nuk përzgjidhet.
19	<b>Ndihmo edhe Ti</b>	Fëmijët në situatë të renda sociale/ pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik për humbjen e përkujdesjes prindërore.	15.4	Organizata aplikuese nuk ka definuar qartë përfituesit, nuk ka planifikuar aktivitetet. Komfor dokumenteve të kërkuara, organizata aplikuese nuk ka sjell dëshmi nga gjykata se është nën administrim të dhunshëm(falimentim) dhe mungojnë deklaratat e stafit sipas kriterëve që janë kërkuar
20	<b>Humanus Vita</b>	Promovimi i aftësisë së kufizuar si vlerë në komunën e Prishtinës	14.4	Organizata, në projekt nuk ka orientim të duhur në adresimin e problematikes së komunitetit me aftësi të kufizuar. Thirrja publike për financim është e orientuar drejtë ofrimit të shërbimeve direkte për të cilën OJQ-ja nuk dëshmon se ka përvojë tani ose në të kaluarën,

				rrjedhimisht nuk plotëson kushtet për tu përzgjedhur fituese.
21	<b>Vita Jeta</b>	Kujdesi dhe Mirëqenia për moshën e tretë	13.4	Komisioni ka konstatuar se Organizata në fjalë ka mungesë të dokumentacionit sipas kriterëve të thirrjes publike për financim.
22	<b>Qendra për hulumtime psiko-sociale dhe mjekësore QHPSM</b>	Evidence-Based Mentoring	12.2	Komisioni ka konstatuar se Organizata në fjalë ka mungesë të dokumentacionit sipas kriterëve të thirrjes publike për financim.
23	<b>Puzzle for Autism</b>	Të i kuptojmë dhe të i përkrahim	12.2	Organizata Aplikuese nuk i ka të gjitha dokumentet sipas thirrjes për mbështetje financiare (vërtetimi nga ATK është pa afat në momentin e aplikimit, si dhe mungon vërtetimi nga Gjykata).
24	<b>Shoqata sindikale e pensionistëve</b>		11.2	Organizata aplikuese nuk e ka përmbushur kërkesën e thirrjes. Ka mungesë të dokumenteve: Forma e aplikimit, Buxheti. Dokumentacioni përcjellës nuk janë sipas formatit të kërkuar në thirrjen publike.
25	<b>Organizata për Hulumtime Ekonomike dhe Sociale-OHES</b>	Aftësim profesional për të rinjtë e minoriteteve etnike në komunën e Prishtinës	11	Komisioni ka konstatuar se përcaktimi i objektivave nuk është definuar qartë dhe nuk dëshmon mundësi të ndikimit në jetën e përfituesve pasi kohëzgjatja e projektit është e shkurtë për të cilën komisioni konstaton që afati kaq i shkurte nuk arrin ndikimin dhe rezultatet e pretenduara.
26	<b>Agro Medicine</b>	Edukime shëndetësor për	11	Komisioni ka konstatuar se projekti nuk është në përputhje



		nenat kryefamiljare dhe ngritja e kapaciteteve te tyre për punësim miqësor me kohe te pjesshme apo vetëpunësim te qëndrueshëm		me termat e thirrjes publike, nuk është ne përputhje me orientime strategjike te Drejtorisë po ashtu nuk është bindëse për stafin i te cilit ju mungon përvoja relevante për punën me kategorinë për te cilët janë të shprehur se do të punojnë.
27	<b>NGO Lady</b>	“Zhvillimi psiko-social dhe profesional për vajzat dhe gratë e Prishtinës”	10.8	Komisioni konstaton se organizata nuk i ka sjellë dokumentet e kërkuara sipas thirrjes publike për aplikim, ku për rrjedhojë kjo organizatë nuk kalon.
28	<b>Shqiponjat e Dardanes</b>	Programi i Drejtuesve te Rinj te Shëndetit Mendor, Mirëkuptimit ndaj Diferencave dhe Barazisë ne Shoqëri e Mirëqenie Sociale ne Kryeqytet	10.6	Organizata aplikuese ka ngatërruar qëllimin, objektivat dhe aktivitetet Ngatërrimi i objektivave te cilat nuk janë ne harmoni njëra me tjetrën, komisioni ka vlerësuar se e bën te pamundur realizimin e projektit dhe arritjen e rezultateve.
29	<b>Youth Ecological and Security Zone - EcoZ</b>	Fuqizimi i te rinjve me aftësi të kufizuara të Prishtinës	10.6	Organizata aplikuese nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në bazë të thirrjes publike për mbështetje financiare, ku mungojnë: dëshmia nga Gjykata se nuk është nën falimentim dhe dëshmi për projektet paraprake. Komisioni vlerësues konstaton se nuk përmbushë kushtet për përkrahje financiare.
30	<b>Shift Youth Organisation</b>	Parandalimi i ngacmimeve kibernetike tek te rinjtë	10.4	Organizata nuk posedon dokumentacionin e kompletuar sipas thirrjes publike: certifikatën nga gjykata që nuk është nën administrim të

				dhunshëm dhe dëshmitë për realizimin e projekteve të ngjashme të realizuara.
31	<b>You Can Do</b>	Gjithë përfshirja dhe aktivizimi psiko – fizik i komunitetit të verbër	10.2	Organizata aplikuese nuk i përmbush kërkesat dhe kriteret e thirrjes publike për financim pasi që projekti nuk është shumë konciz dhe nuk i kontribuon termave të thirrjes publike. Si i tillë komisioni vlerëson se nuk do të përkrahet nga kjo thirrje.
32	<b>Dija Jone</b>	Ambient miqësor për vajzat në shkollë	10.2	Organizata aplikuese nuk ka kompletuar dokumentacionin e duhur për aplikim (nuk ka sjellë dëshmi të projekteve të mëhershme të realizuara) si dhe certifikata e evidencës penale është individuale pa afat dhe jo e bashkangjitur për OJQ-në siç është kërkuar .
33	<b>Rrënjët tona</b>	Ndihmë për mirëqenie sociale	10,0	Organizata aplikuese nuk ka dëshmi për realizimin e projekteve në të kaluarën për ofrim të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mungon certifikata nga Gjykata që OJQ-ja nuk është nën administrim të dhunshëm
34	<b>Organizata për Përkujdesje të Pensionistëve dhe të moshuarve të Kosovës</b>	Ofrimi i shërbimeve psiko sociale për të moshuarit në nevojë	10.0	Organizata aplikuese nuk ka ofruar dëshmi për përvojën paraprake në realizimin e projekteve të ngjashme. Po ashtu stafi profesional i angazhuar në projekt nuk dëshmon kualifikimet adekuate për programin e parashikuar.
35	<b>Instituti i Kosovës për Marrëdhënie me Publikun</b>	Mbështetje e të moshuarve në ane të aktiviteteve rekreative	10.0	Organizata nuk e ka kompletuar aplikacionin sipas kërkesës së thirrjes publike ku për rrjedhojë komisioni ka vlerësuar se nuk kualifikohet për mbështetje financiare.

36	<b>Shoqata e Pensionistëve Invalidore Komunës se Prishtinës</b>	Rehabilitimi i pensionistëve invalidor të Prishtinës		Dokumentacioni i projektit nuk është i kompletuar dhe nuk është ne përputhje me thirrjen publike.
37	<b>Women World Today and Now</b>	Diskriminimi ndaj PAK-ut dhe Mbrojtja Ligjore – E Drejta e Punës	10.0	Projekti nuk është i kompletuar sipas thirrjes publike për mbështetje financiare. Ka mungese dokumentacioni: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëshmia nga gjykata që nuk është nën falimentim.</li> <li>• Dëshmitë për projektet e realizuara me herët.</li> </ul>
38	<b>Qyteti Ynë</b>	Përkrahje për të rinjtë e Komunës se Prishtinës	10.0	Organizata aplikuese ka mungese të dokumentacionit, ku i mungon certifikata nga Gjykata se OJQ-ja nuk është në administrim të dhunshëm, dëshminë për projekte paraprake dhe deklarata nga stafi.
39	<b>Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim</b>	“Ndihmë shkollore në nxënie në shtëpi për fëmijë në nevoja të veçanta, ata pa përkujdesje prindërore në mësim”.	10	Komisioni konstaton se nuk është kompletuar dokumentacioni sipas thirrjes publike.
40	<b>DITA</b>	“Shëndeti dhe Bashkëpunim: Përmirësim i Kujdesit Shëndetësor”.	10	Komisioni konstaton se kësaj Organizate i mungon vërtetimi valid i Gjykatës.
41	<b>YMCA MOVEMENT</b>	“Rise Ability”	10	Komisioni ka konstatuar se Organizata është me adresë në Gjakovë, gjë që është në kundërshtim me rregullat e thirrjes publike.
42	<b>Autizmi Flet</b>	Përmirësimi i mirëqenies se	10	Komisioni ka konstatuar se Organizata në fjale ka mungesë

		personave me aftësi te kufizuar dhe familjeve te tyre përmes vizitave shtëpiake		të dokumentacionit të përcaktuara sipas kriterëve të thirrjes publike për financim
43	<b>Instituti i Shërbimeve Psikologjike KUTIA</b>	Zhvillimi i Familjes përmes lojës	10	Komisioni ka konstatuar se Organizata në fjale ka mungesë të dokumentacionit të përcaktuara sipas kriterëve të thirrjes publike për financim
44	<b>Shoqata ndër komunale e të verbërve Prishtine</b>	Orientim ne hapësire e Mobilitete dhe Shkathtësi për jetë	10	Komisioni ka konstatuar se Organizata në fjale ka mungesë të dokumentacionit të përcaktuara sipas kriterëve të thirrjes publike për financim
45	<b>Research</b>	Fuqizimi i grave te komuniteteve pakice ne Komunën e Prishtinës	10	Komisioni ka konstatuar se Organizatës i mungon vërtetimi nga Gjykata qe nuk është ne falimentim, dëshmitë për përvojën e mëhershme dhe deklaratat e stafit.
46	<b>HUMANIKOS</b>	/	10	Komisioni ka konstatuar se organizata nuk i ka përfillur formularët e aplikimit në bazë të thirrjes publike për aplikim.
47	<b>Instituti për Hulumtime për te Drejtat e Njeriut</b>	Thuaj jo Krugës	7.4	Organizata nuk e ka të kompletuar dosjen sipas kërkesave të thirrjes publike. Sipas thirrjes publike aplikacioni pa dokumentet e kërkuara nuk merret në konsiderate. Organizata aplikuese nuk ofron asnjë dëshmi te përvojës ne realizmin e një projekti te tille pra OJQ konsiderohet se nuk ka kapacitete përvojë ne zbatimin e projektit.
48	<b>The Right One - E duhura</b>	Dore ne Dore	0	Organizatës aplikuese i mungon dokumentacioni ne

				bazë të thirrjes për mbështetje financiare; Forma e deklaramit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit, Dëshmia nga aplikuese se nuk ka falimentuar, CV e stafit janë të mangëta dhe nuk ka dëshmi të projekteve paraprahe.
--	--	--	--	--

**II.** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga komisioni vlerësues.

### **Arsyetim**

Komisioni për Vlerësim brenda afateve të përcaktuara ka bërë hapjen dhe vlerësimin e secilit aplikacion të dorëzuar nga OJQ-të. Në thirrjen e hapur publike në fushën e Shërbimeve Sociale, kanë aplikuar 84 (tetëdhjetë e katër) OJQ, ku komisioni ka analizuar dhe vlerësuar secilin aplikacion në mënyre individuale dhe të pavarur. Komisioni ka konstatuar se 48 (dyzet e tetë) OJQ- të sipërshënuara me lartë nuk i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme, kriteret specifike dhe nuk kualifikohen për të përfituar mbështetje financiare nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

**Udhëzim Juridik:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 5 ditësh në Komisionin e Ankesave në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.

### **I DORËZOHET:**

- OJQ-ve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.